



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 90

Prishtinë, më 20.09.2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Ganimete Musliu, Vjollca Krasniqi, Rasim Demiri dhe Danush Ademi.

Mungoi: Anton Quni.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha-OSBE, Dhurata Kryeziu-OSBE dhe Avni Arifi-CDF.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.09.2013;**
3. **Shqyrtimi i Vendimit të Komisionit për mbikëqyrjen e gradës së nënkolonelit në Policinë e Kosovës**
4. **Diskutim rreth vizitës studimore e cila do të realizohet nga data 22-26 shtator 2013, në Lubjanë;**
5. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- A pajtoheni me rendin e ditës?

Rexhep Selimi- Në mbledhjen e fundit të grupit punues për mbikëqyrjen e procesit të gradimeve në Policinë e Kosovës, kemi marrë vendim që mbikëqyrja t'i bëhet gjithë procesit të gradimeve dhe jo vetëm për gradën e nënkolonelit, siç është përcaktuar në Vendimin e Komisionit. Prandaj propozoj që në rend dite të jetë, shqyrtimi i Vendimit për grupin punues për mbikëqyrjen e gradës së nënkolonelit në Policinë e Kosovës.

Fatmir Xhelili- Propozoi që si Komision të shfaqim përkrahjen për policinë e EULEX-it, Policinë e Kosovës dhe institucionet e Kosovës, për zhvillimet në pjesën veriore, duke kërkuar nga institucionet fuqizimin dhe shtimin e masave të përkujdesjes për institucionet.

Kryetari i Komisionit- Nëse pajtoheni në pikën 3, e fusim propozimin e z. Rexhep Selimi, ndërsa kërkesa e z. Fatmir Xhelili është e pranueshme.

Si Komision shprehim indinjatën e thellë, me rastin që ka ndodhur në veri të Kosovës, ku është vrarë një zyrtar policor i EULEX-it. Për këtë çështje kam kontaktuar me përfaqësuesit e EULEX-it, dhe u kam kërkuar që si Komision t'i bëjmë vizitë policit tjetër të lënduar, dhe është shprehur mirënjohje nga ana e tyre për këtë gatishmëri.

Ky rast është një veprim terrorist, i drejtuar ndaj organeve të sigurisë.

Kërkesa jonë është që të bëhet një angazhim më i madh i institucioneve të sigurisë në Kosovë duke shtuar aktivitete të tyre, në mënyrë që mos të përsëriten veprime të tilla.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

Në pikën e 3 të rendit të ditës hyn pika:

Shqyrtimi i Vendimit të Komisionit për mbikëqyrjen e gradës së nënkolonelit në Policinë e Kosovës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 11.09.2013

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e procesverbaleve, nga mbledhjet e mbajtura 11.09.2013

Procesverbalet u miratuan pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Vendimit të Komisionit për mbikëqyrjen e gradës së nënkolonelit në Policinë e Kosovës

Rexhep Selimi- Komisioni në sesionin pranveror ka marrë vendim për mbikëqyrjen e procesit të gradimeve për gradën e nënkolonelit. Grupi punues ka vlerësuar që domeni i mbikëqyrjes të zgjerohet, duke mos u kufizuar vetëm për gradën e nënkolonelit, por për të gjitha gradat, prandaj kërkojmë nga Komisioni që të merret ky vendim.

Fatmir Xhelili- Pajtohem që të mbikëqyret procesi i gradimeve në Policinë e Kosovës, nëse në vendimin paraprak nuk është paraparë kështu, për të parë nëse i janë përmbajtur procedurave që i parasheh Ligji i Policisë së Kosovës për çështjen e gradimeve.

Rexhep Selimi- Në sesionin pranveror vendimi është marrë për mbikëqyrjen e gradës së nënkolonelit në Policinë e Kosovës dhe kjo është vlerësuar si kufizim, ndërsa vazhdimi i punës nga ana e grupit punues pa këtë ndryshim nuk është parë e arsyeshme.

Vjollca Krasniqi- Mbështes propozimin e kryesuesit të grupit punues për mbikëqyrjen e gradimeve në Policinë e Kosovës për zgjerimin e mandatit të tyre. Ky grup ka kohë që është formuar. Deri ku keni arritur me punën tuaj?

Rexhep Selimi- Konsideroi se kjo fazë është e rëndësishme për mbikëqyrjen e procesit të gradimeve, pasi deri tani procesi ka qenë teknik. Mbikëqyrja do t'i referohet edhe si ka vajtur rrjedha deri tani, por aktiviteti i grupit punues është ndikuar edhe nga agjenda e Komisionit që ka qenë e ngarkuar.

Ganimete Musliu- Pas vendimit të marrë në Komision për formimin e grupit punues, grupi vetëm është konstituar dhe tutje e kemi konsideruar të nevojshme ndryshimin e vendimit. Me qëllim të respektimit të hierarkisë, kemi dashur që ky vendim të ndryshohet në Komision.

Kryetari i Komisionit- Si Komision do të aprovojmë që grupi punues të vazhdojë në mbikëqyrjen e gradimeve në Policinë e Kosovës.

Në këtë pikë të rendit të ditës Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime morri këtë:

VENDIM

Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e gradimeve në Policinë e Kosovës me këtë përbërje: Anton Quni- kryesues, Rexhep Selimi dhe Ganimete Musliu- anëtarë.

4. Diskutim rreth vizitës studimore e cila do të realizohet nga data 22-26 shtator 2013, në Lubjanë

Kryetari i Komisionit- Programin për këtë vizitë studimore tashëm e keni. A janë të gjithë anëtarët pjesëmarrës në këtë vizitë?

Nga konfirmimi në këtë vizitë do të jetë i gjithë Komisioni, gjithashtu të ftuar janë edhe disa anëtarë të Komisionit për AKI dhe përfaqësues të mekanizmave të tjerë të sigurisë dhe drejtësisë. Falënderojmë DCAF për këtë vizitë.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- A ka dikush për të shtuar në këtë pikë?

Fatmir Xhelili- Propozimi im mund të jetë me vonesë, por nëse ka mirëkuptim mund të gjej zbatim. Te projektligji për Komisionarin për FSK-në dhe PK-në, propozoj që në fazën finale në të të përfshihen edhe zjarrfikësit.

Marr në konsideratë numrin vogël të tyre dhe faktin se kjo strukturë kontribuon në situata emergjente dhe vlera e punës së tyre është e admirueshme, ndërsa duket një neglizhim nga shoqëria për këtë strukturë. Prandaj vlerësoj se përfshirja e tyre në projektligjin për Komisionarin do t'u ofronte një mekanizëm atyre.

Gjithashtu si Komision do të mund të realizonim një takim me përfaqësuesit e zjarrfikësve, për definimin e statusit të tyre, pasi sipas ligjeve janë zyrtarë civilë, ndërsa ata janë strukturë profesionale, dhe fakti që janë kategorizuar si zyrtar civil i shmang nga disa beneficione si profesionist.

Me një propozim për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Zyrtarët Civilë dhe Projektligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, bashkë me propozimin që të përfshihen në Projektligjin për Komisionarin, do tu lehtësohej puna e tyre.

Rexhep Selimi- Për propozimin e z. Xhelili për përfshirjen e zjarrfikësve në kuadër të Projektligjit për Komisionarin në një aspekt jemi vonë, pasi ky projektligj është në faza të tjera, ndërsa propozimi i një amendamenti për këtë çështje mund të bëhet gjatë leximit të parë dhe të dytë, por kam rezerva për këtë çështje.

Ndërsa e mbështes propozimin e dytë për zjarrfikësit, pasi kjo strukturë duhet të jetë e trajtuar mirë për shkak të natyrës së punës që kanë.

Fatmir Xhelili- Propozimin për përfshirjen e zjarrfikësve në kuadër të Komisionarit, janë marrë në konsideratë disa elemente, janë të uniformuar, duhet të jenë strukturë profesionale dhe nuk janë numër i madh, prandaj vlerësoj se mund të menaxhohet duke e përfshirë në projektligj.

Rexhep Selimi- Sa i përket elementit se zjarrfikësit janë strukturë e uniformuar, ka edhe struktura të tjera të uniformuara, por mbetet mes leximit të parë dhe të dytë për të diskutuar këtë çështje.

Vjollca Krasniqi- Sa i përket çështjes së zjarrfikësve, kjo strukturë ka mbetur me status pezull si zyrtar civil dhe profesionist dhe se punëtor të kujt janë. Ligjërisht i takojnë Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, ndërsa tani janë punëtorë të komunave, prandaj mendoj që këtë vit, Agjencia për Menaxhimin Emergjent nuk do të vonohet për propozimin e buxhetit që ata të paguhen nga kjo Agjenci, pasi ata nuk e dinë se zyrtarë të kujt janë. Prandaj si Komision duhet të bëjmë thirrje Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, që të jenë më të kujdesshëm në trajtimin e zjarrfikësve.

Fatmir Xhelili- Pajtohem pjesërisht me znj. Krasniqi, dhe pasi Projektligji për Agjencinë për Menaxhimin Emergjent do të vijë në trajtim në Komision, presim nga Agjencia të bëhet planifikimi me kohë për 2014 dhe detajet e vijave buxhetore për Agjencinë për Menaxhimin Emergjent.

Kjo çështje është më e komplikuar, pasi ndahen grante për kokë banori për menaxhim të emergjencave dhe zjarrfikësit funksionalisht do të jenë Agjenci por praktikisht tek emergjencat komunale do të jenë pjesë e komunave.

Ndërsa sa i përket planifikimit buxhetor për mallra dhe shërbime, pajisjet teknike, në këto planifikime duhet të bëhen me kohë që në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2014, 2015 dhe 2016, do të mund të krijohej një Agjenci me të gjitha njësitë e zjarrfikësve për komunat e Kosovës.

Kryetari i Komisionit- Propozoj që si Komision të realizojmë një vizitë në Qendrën e Zjarrfikësve në Prishtinë, për të parë mënyrën se si funksionojnë. Gjithashtu si Komision kërkojmë që Projektligji të silllet sa më shpejt në Komision, për të bërë plotësimet për Agjencinë për Menaxhimin Emergjent, duke ia caktuar bazën ligjore për funksionimin e tyre.

Ndërsa sa i përket Projektligjit për Komisionarin, është realizuar takim me Sekretarin e Kuvendit të Kosovës, ku janë dhënë disa sugjerime dhe vërejtje për këtë projektligj, siç është funksionalizimi i zyrës së Komisionarit, stafit dhe definimit në ligj se të kujt janë këta punëtorë? Ndërsa nga ana e z. Reinhold Robbe është shprehur gatishmëri për të ofruar sqarime për këto çështje.

Fatmir Xhelili- Sa i përket vizitës në Njësinë Zjarrfikësve, propozoj që më mirë është që të ftohen përfaqësuesit e Agjencisë për të diskutuar për planifikimet buxhetore, ndërsa pas përfundimit të zgjedhjeve lokale mund të realizohen vizita, duke mos lënë përshtypje se këto bëhen për qëllime elektorale.

Kryetari i Komisionit- Jemi dakord që të kemi takim me përfaqësuesit e Agjencisë për Menaxhimin Emergjent dhe të dihen pikëpamjet e tyre.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi